

# RELACION

## PËR

### **PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË QËLLIMIT, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, PËR INSTALIMIN DHE PËRDORIMIN E SISTEMIT PËR KRAHASIMIN DHE VLERËSIMIN E SIGURT TË IDENTIFIKIMIT PERSONAL (PISCES)”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES).

Me anë të këtij memorandumi, qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës bien dakord që kjo e fundit të instalojë Sistemin për Krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES), për monitorimin e lëvizjes së udhëtarëve në pikat e kontrollit kufitar që do të përcaktohen bashkërisht nga palët.

Nëpërmjet bashkëpunimit të qeverisë së Shqipërisë, qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të instalojë dhe do të mirëmbajë të gjitha pajisjet elektronike të nevojshme për funksionimin e sistemit PISCES, duke filluar në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. Në vijim, instalimi i sistemit PISCES do të zgjerohet edhe në aeroporte apo pika të tjera kufitare, të caktuara nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Bazuar në përcaktimet e memorandumit, qeveria e Shqipërisë do të fillojë përzgjedhjen e personelit që do të operojë me sistemin PISCES dhe do ta mirëmbajë atë. Trajnimi i personelit, me qëllim dhënien e njohurive të duhura dhe krijimin e kapaciteteve të kualifikuara, do të realizohet nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Miratimi, në parim, i memorandumit është bërë me vendimin nr.479, datë 28.6.2017, të Këshillit të Ministrave, ndërsa nënshkrimi në datën 22 mars 2018.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e Sistemit për Krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES)” hartohet në përputhje me programin politik të qeverisë shqiptare, kapitulli “Shteti i së drejtës dhe demokratizimi i shoqërisë/Krimi i organizuar, terrorizmi e trafikimi”.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Me anë të këtij memorandumit do të ngrihet një sistem i cili shton disa elemente sigurie të kontrollit në pikat e kalimit kufitar. Elementi kryesor është ai i të dhënave biometrike të cilat do të identifikojnë edhe raste të vështira për t'u zbuluar nëpërmjet sistemit aktual. Gjithashtu, instalimi i këtij sistemi do të shoqërohet me një rinovim të infrastrukturës, duke pajisur çdo punonjës me kompjuter, lexues dokumentesh, lexues gjurme gishti, kamera për kontrollin e fytyrës.

Këto të dhëna do të krahasohen me regjistrat e Interpolit dhe të FBI-së, duke na dhënë një përparësi në zbulimin dhe ndalimin e personave të kërkuar në nivel ndërkombëtar.

## **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Ky projektligj nuk parashikon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përmban dy nene në të cilët parashikohet:

Neni 1, përcakton ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për

instalimin dhe përdorimin e Sistemit për Krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Në nenin 2 është përcaktuar hyrja në fuqi e projektligjit.

Me bashkëpunimin e qeverisë së Shqipërisë, qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synon të instalojë dhe të mirëmbajë të gjitha pajisjet elektronike të nevojshme për sistemin PISCES, duke filluar në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, si dhe duke u zgjeruar më pas në aeroporte dhe pika kufitare të tjera, të caktuara nga autoritetet e qeverisë së Republikës së Shqipërisë në bashkërendim me autoritetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synon të kontribuojë në përgatitjen e infrastrukturës së ofruar nga qeveria e Shqipërisë, të nevojshme për instalimin dhe operimin e PISCES-it në mënyrë të vazhdueshme. Sistemi do të shërbejë për përmbushjen e një ndër objektive të Ministrisë së Brendshme, sigurimin e menaxhimit të integruar të kufijve.

Ministria e Brendshme, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga memorandumi, do të fillojë përzgjedhjen e personelit të qeverisë pritëse për të operuar dhe mirëmbajtur sistemin PISCES, me kusht që qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të ketë si qëllim trajnimin e këtij personeli për të krijuar një kuadër të kualifikuar për këtë sistem.

Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë do të përjashtojë nga taksa e TVSH-së dhe detyrimet doganore të gjitha pajisjet dhe pajisjet kompjuterike që i përkasin sistemit PISCES dhe që importohen në dobi të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synojnë të bashkërendojnë rishikime periodike në mënyrë që të inventarizohen dhe të përditësohen mjetet dhe pajisjet kompjuterike të siguruar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për sistemin PISCES.

Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë ka për qëllim të vendosë në punë, të administrojë dhe të mirëmbajë pajisjet e parashikuara për sistemin PISCES, posaçërisht për qëllimet e specifikuar në memorandumin e qëllimit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale të garantuara si për qytetarët e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe shtetasit e huaj që vizitojnë Shqipërinë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen për zbulimin dhe ndalimin e personave të kërkuar ndërkombëtarisht. Të dyja qeveritë synojnë të bashkërendohen përpara çdo transferimi apo zhvendosjeje të mjeteve dhe pajisjeve kompjuterike të PISCES.

Me qëllim zbatimin e këtij memorandumi qëllimi, përfshirë transmetimin dhe marrjen e çdo njoftimi, kërkesë, dokumenti ose ndonjë komunikimi tjetër, pikat e kontaktit duhet të jenë, si më poshtë:

Për qeverinë e Republikës së Shqipërisë, ministri i Brendshëm ose çdo person i caktuar nga ministri;

Për qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri ose çdo person i caktuar nga Ambasadori.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit) ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji për ratifikimin e memorandumit të qëllimit është hartuar nga Ministria e Brendshme.

Gjatë fazës së negociimit dhe miratimit, në parim, të marrëveshjes, projektakti i është dërguar për mendim pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Shërbimit Informativ të Shtetit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Qeveria e SHBA-ve do të sigurojë të gjitha mjetet dhe pajisjet kompjuterike që i përkasin sistemit "PISCES" dhe që importohen në dobi të qeverisë së Shqipërisë.

Qeveria e Shqipërisë do të përjashtojë nga taksa e TVSH-së dhe detyrimet doganore për të gjitha mjetet dhe pajisjet kompjuterike që i përkasin sistemit PISCES dhe që importohen në dobi të qeverisë së Shqipërisë, nëpërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**